

KONTRATA

KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik **MAZREKU SH.P.K.**; **AAB CONSTRUCTION SH.P.K.**,
Guriq, 24000, Malisheve (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të
lidhin një kontratë publike për:

Tituulli i kontratë : Rekonstruimi I objektit të shërbimeve rezidenciale-Garazha


me numër Identifikues **631-20-2436-5-3-6** mr nr. të bren. **631 20 022 536**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Rekonstruimi I objektit të shërbimeve rezidenciale-Garazha sipas specifikimit teknik ose paramasës dhe parallogarisë.**

1.2 **Kontrata hynë në fuqi me 26.06.2020 dhe përfundon me 26.08.2020.**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **60** ditë nga data e marrjes së urdhëreses.



1.4 Vendi i *ekzekutimit të punëve* do të jetë *Qendra Rezidenciale në Deçan*.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 **Cmimi total i kontratës do të jetë: 7.444,90 Euro ;**
[Shtatëmijëkaterqindkaterdhjetekater e enentdhjetë] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *punëve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *punëve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *te kryej ndonjë ose te gjitha punët* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[punëve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti

Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Bashkim Mazrreku	Emri:	Xhevdet Ramosaj
Pozita:	Menaxher	Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.06.2020	Data:	26.06.2020
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

REGULLIMI I HAPESIRAVE PER ALUMIN DHE REKREIM NE SHITESHINE E KOMUNITETIT

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera €
1	I. PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT				
1.1	Pastrimi i terrenit, largimi i pengesave në tërë sipërfaqën ekzistuese, nxjerrja dhe largimi i mbetjeve të betonit dhe mbetjeve tjera nga rrethoja dhe punimet para-prake.	m ²	100.00	2.00 €	200.00 €
1.2	Gropimi i gjerë i dheut për fondimin e bazamentit të planifikuar sipas zgjidhjes arkitektonike, me lartësi të disniveelit deri në 1.2m	m ³	650	0.70 €	455.00 €
1.3	Gropimi i dheut për hapjen e themeleve shiritore me dimensione 60x45.	m ³	15.6	10.00 €	156.00 €
1.4	Furnizimi dhe blerja, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorit 0.60mm nën "themele" dhe nën bazamentët e projektuara t = 20cm.	m ³	13.4	13.00 €	174.20 €
1.5	Furnizimi dhe Blerja, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e shtresës së zhavorit 0.31mm tek hapësira perimetrike e gabaritit të objektit duke filluar nga mbulimi i drenazhës, skaj bazës së objektit, deri në nivelin e tokës tek kuota e parterit rrethues me nivelin e zbranzës.	m ³	11.6	13.00 €	150.80 €
Gjithsej:					1,136.00 €

2	II. PUNËT NË PLATONË DHE TËRË SIPËRFAQËN				
2.1	Furnizimi dhe betonimi i shtresës rrafshuese për themele, dhe themeleve të pozicionuara sipas kalkulimeve statike. t=10cm- C-16/20	m ³	2.86	70.00 €	200.20 €
2.2	Furnizimi dhe betonimi i themeleve shiritore 45x60 arkitektonike sipas projektit , C-30/37, dhe të armohet me armim fi 12mm dhe 8mm	m ³	14	55.00 €	770.00 €
2.3	Furnizimi dhe betonimi cokulave 25x45, C-30/37 dhe të armohet me armim fi 12mm dhe 8mm	m ³	11.15	55.00 €	613.25 €
2.4	Furnizimi dhe betonimi i pllakes së themeleve me trashësi t=20cm dhe të armohet me armim fi 12mm dhe 8mm	m ³	19	55.00 €	1,045.00 €



2.5	Furnizimi dhe betonimi I murit mbrojtës për pjesën e prapme të garazhës për mbrojtje nga dheu h=1.2m,t=25 dhe të armohet me armim fi 12mm dhe 8mm	m3	6.75	55.00 €	371.25 €
2.6	Furnizimi dhe betonimi I kanalit për rregulimin e makinave me dimensione 9x5x1	m2	35	5.00 €	175.00 €
Gjithsej:					3,174.70 €

2	II. PUNËT NË KONSTRUKCIONIN METALIK DHE MBULESA				
2.2	Furnizimi dhe ndertimi I shtyllave të çelikut 160x160x6.3 h=3.6m	kg	404	0.80 €	323.20 €
2.3	Furnizimi dhe ndertimi I 9 kapriatave nga çeliku me profila :brezi I sipër dhe I poshtëm 80x80x5,diagonalet dhe vertikalet 80x60x4. Ku në këtë pozicion të përfshihen saldimit dhe pllakat lidhëse të jenë të lyera me ngjyrë kundër korodimit.	kg	1023.2	0.80 €	818.56 €
2.3	Furnizimi dhe ndertimi I brinaqeve me profila tubo 120x80x5 dhe shtangimet me tubo 80x80x4	kg	1034.3	0.80 €	827.44 €
2.3	Furnizimi dhe montimi I profilit metalik për shtangimet horizontale dhe vertikale	kg	985	1.00 €	985.00 €
2.3	Furnizimi dhe montimi I llamarines së vëzuar antracid r16000,për pjesën e garazhës mbulesës dhe mureve mbështjellëse	m2	90	2.00 €	180.00 €
Gjithsej:					3,134.20 €

REKAPITULLIM I PARAMASES	
I. PUNËT E DHEUT DHE ZHAVORIT	1,136.00 €
II. PUNËT NË PLATONË DHE TËRË SIPËRFAQËN	3,174.70 €
II. PUNËT NË KONSTRUKCIONIN METALIK DHE MBULESA	3,134.20 €
GJITHSEJ	7,444.90 €

